



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
MINISTRI

URDHËR

Nr. 331, datë 03/05/2016

PËR

**NGRITJEN E STRUKTURËS SË POSAÇME PËR REGJISTRIMIN, ADMINISTRIMIN DHE
PËRPUNIMI E FORMULARIT TË VETDEKLARIMIT, TË FUNKSIONARËVE POLITIKË
NË KABINETIN E MINISTRIT TË DREJTËSISË**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 e Kushtetutës, të nenit 12 të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, të nenit 7, pika 2 të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar, të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” dhe të vendimit të Kuvendit nr.17, datë 04.03.2016 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr.138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”,

URDHËROJ:

1. Ngritjen e strukturës së posaçme, për regjistrimin, administrimin dhe përpunimin e formularit të vetëdeklarimit të plotësuar nga funksionarët politikë të kabinetit të Ministrit të Drejtësisë.
2. Struktura e posaçme përbëhet nga:
 - Znj.Elona Haska, Inspektore në Sektorin e Inspektimit dhe Organizimit Gjyqësor;
 - Zj.Suela Fetau, Sekretare e Ministrit të Drejtësisë.
3. Sektori i Inspektimit dhe Organizimit Gjyqësor, në çdo rast ofron asistencën e nevojshme për mbarëvajtjen e këtij procesi.
4. Ngarkohet Drejtoria e Inspektimit Gjyqësor dhe Prokurorisë, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI
YLLI MANJANI

